



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 525, datë 24.09.2024

**PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 438 DATË 19.07.2023 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR PËR PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË
FILLUAR NDAJ ISH-MAGJISTRATIT {...} DHE VIJIMIN E SHQYRTIMIT TË
TIJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 97 pika 3 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenet 66, 67, 68 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 438, datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.
2. Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe caktimin e seancës dëgjimore me datë 16.10.2024, ora 11.30.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR